



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

908
Nr. Prot.

Tiranë, më 29 01.2018

URDHËR

Nr. 37, datë 29.01.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË DISPOZITAT NORMATIVE PËR SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR, MIRATUAR ME
URDHRIN NR. 343, DATË 19.08.2013**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në tekstin e Dispozitave Normative për sistemin arsimor parauniversitar, të miratuara me urdhrin nr. 343, datë 19.08.2013, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Pikat 6 dhe 7 të nenit 5 të Kreut II të Dispozitave Normative, ndryshojnë si më poshtë:

"6. Për regjistrimin e fëmijës në kopsht paraqitet vetëm vërtetimi i vaksinimeve nga qendra shëndetësore.

7. Në raste të veçanta, kur prindi nuk ka vërtetimin e vaksinimeve të fëmijës, drejtoresha e kopshtit i kërkon prindit t'i drejtohet qendrës përkatëse shëndetësore dhe pas marrjes së vërtetimit, e regjistron fëmijën."
 - b) Pikat 3 dhe 4 të nenit 13 të Kreut IV të Dispozitave Normative, ndryshojnë si më poshtë:

"3. Për regjistrimin e fëmijës në klasën e parë paraqiten këto dokumente:

 - a) *Vërtetimi i vaksinimeve nga qendra shëndetësore;*
 - b) *Vërtetimi i ndjekjes së kopshtit sipas grupeve, i firmosur nga drejtoresha e kopshtit. (nëse ka)*

"4. Në raste të veçanta, kur prindi dëshiron të regjistrojë fëmijën në klasën e parë, por nuk disponon vërtetimin e vaksinimeve, veprohet si në rastet analoge me kopshtet."
 - c) Pika 3 e nenit 22 të Kreut VI të Dispozitave Normative, ndryshon si më poshtë:

“3. Regjistrimi paraprak i nxënësit në klasën e dhjetë bëhet vetëm me formularin e plotësuar për lëndët me zgjedhje.”.

d) Pika 4 e nenit 27 të Kreut VII të Dispozitave Normative, ndryshon si më poshtë:

“4. Dokumentet për aplikim janë:

a) Kërkesa për regjistrim;

b) Dëftesa e Lirimit të nxënësit;

d) Raport mjekësor për nxënësit që aplikojnë në një shkollë sportive.”.

e) Pika 3 e nenit 90 të Kreut XIV të Dispozitave Normative, ndryshon si më poshtë:

“3. Kërkesa për transferim formulohet më shkrim nga prindi i nxënësit dhe i drejtohet drejtorit të shkollës ku nxënësi është regjistruar. Drejtori i shkollës përgatit dokumentacionin e transferimit brenda 2 ditëve pune dhe ia dorëzon prindit të nxënësit për drejtorin e shkollës pritëse.

Dokumentacioni i transferimit përmban notat ose shprehjet e nxënësit të marra gjatë vitit shkollor deri në çastin e transferimit;

Drejtori i shkollës, ku nxënësi transferohet, njofton menjëherë zyrtarisht për regjistrimin drejtorin e shkollës nga nxënësi vjen. Drejtori i shkollës dërguese, pas këtij njoftimi, bën çregjistrimin e nxënësit.

Lëvizjet e nxënësve pasqyrohen në amzë.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, njësitë arsimore vendore dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

